



RREGULLORE

PËR

LLOGARITJEN E FONDIT TË KOMPENSIMIT SI DHE RASTET E PREKJES, TË NDËRHRYJES DHE RIVENDOSJES SË VLERËS MINIMALE TË FONDIT TË KOMPENSIMIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së fondit të kompensimit, kontributin e çdo anëtari në vlerën minimale të fondit të kompensimit si dhe rastet e prekjës, ndërhyrjes dhe afatet e rivendosjes së kësaj vlere.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 42, pika 2 dhe nenit 48 pika 2, të ligjit 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenit 14, pika 2, të ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit të licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit 32/2021.

KREU II

LLOGARITJA E FONDIT TË KOMPENSIMIT

Neni 4

Fondi i kompensimit

1. Fondi i kompensimit administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve, ndaj pronës dhe ndaj personit, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve të nenit 41, pika 1 të ligjit 32/2021.
2. Shuma e kontributeve të fondit të kompensimit mbahet nga Byroja në një nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, në një llogari qëllimore për fondin e kompensimit, e cila do të titullohet “Fondi i kompensimit”.
3. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, Byroja mban në një llogari të veçantë vlerën minimale të fondit të kompensimit, e cila sipas pikës 2 të nenit 41, të ligjit 32/2021, nuk mund të jetë më e vogël se 150 000 000 lekë.

Neni 5

Llogaritja e fondit të kompensimit

1. Fondi i kompensimit që i takon vitit aktual duhet të jetë në masë të tillë që të përballojë pagesat e dëmeve objekt i fondit të kompensimit.
2. Fondi i kompensimit llogaritet duke vlerësuar:
 - a) kontributin që i takon vitit aktual;
 - b) provigjonet për dëmet e ndodhura në vitet e mëparshme që mbulohen nga fondi i kompensimit sipas nenit 41, të ligjit 32/2021.
3. Llogaritja e fondit shtesë, në rast të pamjaftueshmërisë së fondit me qëllim pagesën e dëmeve objekt fond kompensimi bëhet sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 6

Vlerësimi për kontributin

1. Kontributi që i takon vitit aktual duhet të jetë në masë të tillë që të përballojë dëmet që pritet të ndodhin gjatë vitit aktual dhe që duhet të përballohen nga fondi i kompensimit.
2. Vlerësimi për këtë kontribut, bëhet mbi baza aktuariale mbështetur në të dhëna mbi mjetet e pasiguruara në treg, tendencat e fundit mbi luhatjen e numrit të të pasiguarve dhe detaje që lidhen me to (nëse ka si p.sh. cila është kategoria që ka më tepër mjete të pasiguruara).
3. Pjesë e vlerësimit të kontributit që i takon vitit aktual, do të jenë edhe dëmet e përfunduara për t'u paguar, të cilat nuk përfshihen në provigjionin për dëmet e ndodhura, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Provigjoni për dëmet që mbulohen nga fondi i kompensimit

1. Provigjoni për dëmet e ndodhura që mbulohen nga fondi i kompensimit llogaritet:
 - a) për dëmet e ndodhura dhe të raportuara, të paguara (RBNS);
 - b) për dëme të ndodhura dhe të raportuara (IBNR).
2. Metodologjia për llogaritjen e provigjoneve sipas pikës 1, të këtij neni bëhet në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 8

Fondi i kompensimit në mbyllje të vitit financiar

1. Byroja në fund të çdo periudhe financiare (31 dhjetor), llogarit dhe mban balancën e fondit të kompensimit.
2. Balancat e llogarisë së fondit të kompensimit më datë 31 dhjetor të çdo viti, do të pasqyrohen në bilancin e Byrosë, si detyrime financiare për vitin pasardhës.
3. Në fillim të vitit financiar pasues, Byroja njofton shoqërinë e sigurimit mbi mbartjen e detyrimit të fondit të kompensimit i cili i shtohet kontributit të fondit të kompensimit, për vitin aktual.

KREU III

VLERA MINIMALE E FONDIT TË KOMPENSIMIT

Neni 9

Vlera minimale e fondit të kompensimit dhe kontributi i shoqërive të sigurimit

1. Vlera minimale e fondit të kompensimit, (më poshtë garancia e fondit të kompensimi) ka për qëllim pagesën e dëmeve, sipas nenit 41, të ligjit 32/2021 dhe nuk mund të jetë më e vogël se 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.
2. Kjo vlerë mbahet nga Byroja, si fond garancie në një llogari bankare qëllimore në njërën nga bankat e nivelit të dytë dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Garancia e fondit të kompensimit financohet nga të gjithë anëtarët e Byrosë në mënyrë të barabartë.

Neni 10

Investimi i garancisë të fondit të kompensimit

1. Garancia e fondit të kompensimit investohet vetëm në bono thesari dhe/ose depozita bankare, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit.
2. Totali i investimeve të garancisë së fondit të kompensimit në monedha të huaja, nuk duhet të jetë më shumë se 30% e këtij fondi.
3. Investimet e garancisë së fondit të kompensimit në një bankë të vetme, nuk lejohet të tejkalojnë 25% të këtij fondi.
4. Byroja kujdeset të investojë garancinë e fondit të kompensimit duke konsideruar profilin e rrezikut të çdo investimi.
5. Bonot e thesarit sipas pikës 1 të këtij neni, emërtohen “Bono thesari për garancinë e fondit të kompensimit” dhe përmbajnë kushtin “Nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.
6. Depozitat bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, janë depozita qëllimore dhe emërtohen “Depozitë për garancinë e fondit të kompensimit” dhe kanë si pjesë përbërëse të kontratës së depozitës kushtin “Kjo depozitë nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.

Neni 11

Rastet e prekjes dhe ndërhyrjes së garancisë të fondit të kompensimit

1. Garancia e fondit të kompensimit preket nga Byroja në rast të:
 - a. mospërbushjes së detyrimeve të kontributit për financimin e fondit të kompensimit nga anëtarët;
 - b. mosdepozimit brenda afateve të propozimit për shtesën e fondit të kompensimit, kur fondi rezulton i pamjaftueshëm;
 - c. mosfinancimit të fondit të kompensimit, në rastet e likuidimit apo falimentimit të shoqërisë së sigurimit.
2. Investimet e garancisë së fondit të kompensimit mund të ndryshojnë në rast të:
 - a. ndryshimit të bankës ku është investuar garancia e fondit të kompensimit;
 - b. ndryshimit të llojit të investimit të garancisë së fondit të kompensimit;
 - c. kur vlera e investuar është më e madhe se niveli i garancisë së fondit të kompensimit.

Neni 12

Afatet e rivendosjes dhe ndërhyrjes së garancisë së fondit të kompensimit

1. Në rastin e prekjes së garancisë së fondit të kompensimit sipas nenit 11, pika 1, të kësaj rregulloreje, Byroja njofton shoqërinë e sigurimit për rivendosjen e vlerës së garancisë, duke plotësuar detyrimin e saj brenda 45 ditëve nga data e njoftimit.
2. Në rastin e ndryshimit të investimit të garancisë të fondit të kompensimit sipas nenit 11, pika 2, Byroja njofton me shkrim Autoritetin të paktën 10 ditë kalendrike përpara kryerjes së këtyre ndryshimeve.
3. Pas ndryshimeve të bëra Byroja depoziton në Autoritet:
 - a. një kopje të vërtetimit të ri për investimin në bono thesari 1-vjeçare;
 - b. kontratën e re të depozitës, në ditën e lidhjes së saj.
4. Dokumentacioni sipas pikës 3 të këtij neni, depozitohet në Autoritet në formë shkresore dhe elektronike brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së investimit dhe/ose e lidhjes së kontratës.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021.